



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr _____prot

Tiranë më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 516, datë 24.09.2024

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL ME
QËLLIM PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË VLERËSIMIT (GRADIMIN) TË
GJYQTARËVE QË KANË KALUAR ME SUKSES PROCESIN E RIVLERËSIMIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a” dhe “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 89, pika 1 dhe 171, pika 5 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 61, 63 dhe 86, shkronja “dh” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263 datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, mbi dosjet e dërguara nga organet e rivlerësimit deri në datë 17.09.2024, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe mbas shortit të realizuar,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, për të cilët janë dorëzuar në vijim nga organet e rivlerësimit, dosjet me aktet e vlerësimit profesional.
2. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:
 - i) Për gjyqtaren znj. {...}- Relator z. Ilir Rusi - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. {...};
 - ii) Për gjyqtarin z. {...}- Relator znj. Gentiana Muçaj- Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. {...}
 - iii) Për gjyqtaren znj. {...}- Relator znj. Irena Plaku - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. {...};
 - iv) Për gjyqtarin z. {...}- Relator znj. Irena Plaku - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. {...};

- v) Për gjyqtaren znj. {...}– Relator znj. Gentiana Muçaj - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. {...}.
- vi) Për gjyqtaren znj. {...}– Relator z. Ilir Rusi - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR